

**VENDIM**  
**Nr.697, datë 21.5.2008**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,  
QË DO TË TRASFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,  
KOMUNA KATUND I RI TË QARKUT TË DURRËSIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Katund i Ri të qarkut të Durrësit, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 5 (pesë), dhe lidhja nr.1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Katund i Ri për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

## 2. FORMULARË PËR TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUJTSHME SHTETËRORE

(Sipas inventarizimit të pronave të veçanta të tipit: pyje, kullota, livadhe, shkëmbore etj)

| Institucioni i pushtetit qendror: MMPAU |                       |                                                 |                                                              |                  |               |                  |                                       |                                                  |                                                            |                                        |
|-----------------------------------------|-----------------------|-------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------|------------------|---------------|------------------|---------------------------------------|--------------------------------------------------|------------------------------------------------------------|----------------------------------------|
| Komuna: <b>Katund i Ri</b>              |                       |                                                 |                                                              |                  |               |                  |                                       |                                                  |                                                            |                                        |
| Nr. rend.                               | Nr i pronës sipas VKM | Emërtesa e ekonomisë pyjore dhe kullosore (EPK) | Emërtesa e ngastrës, vendndodhja (sipas emërtesës popullore) | Numri i ngastrës | Destinacioni  | Sipërfaqja në ha | Funksioni për të cilin përdoret prona | Institucioni, enti me përgjegjësi administrative | Institucioni, enti perdorues, statusi juridik i përdorimit | Të dhëna të tjera (shënime të veçanta) |
| 1                                       | 2                     | 3                                               | 4                                                            | 5                | 6             | 7                | 8                                     | 9                                                | 10                                                         | 11                                     |
| 1                                       | 306                   | Shijak-Mamin, Porto Romane                      | Bisht -Pallë                                                 | 5                | Pyll mbrojtës | 2.75             | Mbrojtje terreni                      | MMPAU                                            | DSHP                                                       | Shkurre të rralla dhe të degraduara    |
| 2                                       | 307                   | Porto Romane                                    | Bisht -Pallë                                                 | 6                | Pyll mbrojtës | 4.25             | Mbrojtje terreni                      | MMPAU                                            | DSHP                                                       | Shkurre të rralla dhe të degraduara    |
| 3                                       | 308                   |                                                 | Bisht - Kamëz                                                | 7a               | Pyll mbrojtës | 2.25             | Mbrojtje terreni                      | "                                                | "                                                          | "                                      |
| 4                                       | 309                   |                                                 | "                                                            | 7b               | boshe         | 6                |                                       | "                                                | "                                                          |                                        |
| 5                                       | 310                   |                                                 | "                                                            | 7c               | Pyll mbrojtës | 5                | Mbrojtje terreni                      | "                                                | "                                                          | "                                      |

Njësia e qeverisjes vendore: komuna Katund i Ri

Lidhja nr.1

| <b>Numrat rendorë të pronave në listën<br/>e inventarit</b> | <b>Fusha e përdorimit të pronës</b> | <b>Lloji i transferimit</b> |
|-------------------------------------------------------------|-------------------------------------|-----------------------------|
| 306 -310                                                    | Pyll mbrojtës                       | Në pronësi                  |
|                                                             |                                     |                             |